



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4308 Prot.

Tiranë, më 06.07. 2023

URDHËR

Nr. 340, Datë 06.07.2023

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR” NË
“INXHINERI ROBOTIKE DHE MEKATRONIKE”, (“BACHELOR” IN
“ROBOTICS AND MECHATRONICS ENGINEERING”), NË KOLEGJIN
UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Robotike dhe Mekatronike”, (“Bachelor” in “Robotics and Mechatronics Engineering”) me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Inxhinieri Robotike dhe Mekatronike” (“Bachelor” in “Robotics and Mechatronics Engineering”) në Fakultetin e Inxhinierisë, në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” Tiranë, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Robotike dhe Mekatronike” (“Bachelor” in “Robotics and Mechatronics Engineering”), në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, fillon në vitin akademik 2023-2024.
3. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, të përmbushë rekomandimet e ekspertëve, para fillimit të vitit akademik 2023-2024, në lidhje me:
 - a) Rishikimin e planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve, në përputhje me vendimin nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.

- b) Paraqitjen e një analize të peshës dhe ngarkesës që hapja e këtij programi do të ketë në tërësi për institucionin, si në nivel mjaftueshmërie ambientesh, ashtu edhe ngarkese të stafit akademik në përputhje me udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018, *“Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”*, të ndryshuar, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- c) Rishikimin e rregullores së programit të studimit duke specifikuar kriteret, kushtet dhe procedurat për pranimin, transferimin, ndërprerjen dhe rifillimin e studimeve.
4. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI

